RAPORTI I PROGRESIT VJETOR **2018**

SEKRETARIATI NISMA PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRINË NXJERRËSE QERSHOR 2019 SHQIPËRIA

EITI Extractive Industries Transparency Initiative

ALBANIA

NJË VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I PERFORMANCËS NË 2018

NË PËRPUTHJE ME KËRKESËN 7.4 (a) (i)

Gjatë vitit 2018 u organizuan katër mbledhje të Grupit Ndërinstitucional të Punës (MSG).

Në këto mbledhje janë diskutuar dhe shqytuar Plani i Punës EITI 2018- 2019; Plani lidhur me Veprimet Korrigjuese (Corrective Actions) të Përcaktuara nga Bordi Ndërkombëtar EITI në lidhje me proçesin e Validimit në Shqipëri; Azhornimi lidhur me proçedurat dhe statusin e Projektit Pilot mbi "Commodity Trading", miratimi i Termave të Referencës për Administratorin e Pavarur, i cili do të përgatisi Raportin zyrtar EITI për vitet 2017 dhe 2018; Termat e Referencës për aktivitetet e Komunikimit dhe Promovimit EITI.

Grupi Ndërinstitucional i Punës (MSG) trajtoi me rëndësi të veçantë fushat e mëposhtme të veprimtarisë EITI në Shqipëri:

TERMAT E REFERENCËS PËR RAPORTIN EITI 2017 dhe 2018

Grupi Ndërinstitucional i Punës (MSG) dhe Sekretariati Kombëtar EITI draftuan Termat e Referencës për Administratorin e Pavarur i cili do të përgatisi Raportin EITI 2017dhe 2018.
Ky Draft pasi është diskutuar në të gjitha fazat e detajuara të tij, përfshin komentet dhe sygjerimet e bëra nga anëtarët e MSG, si dhe të grupimit të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të Biznesit.
Risia që Sekretariati Kombëtar EITI ka propozuar dhe mbështetur konsiston në faktin se për herë të parë, pjesë e grupit të punës të Administratorit të Pavarur, kërkohet të jenë pjesëmarrja e stafeve me kapacitet teknik sektorial nga fusha e minierave dhe hidrokarbureve.
Po ashtu, Sekretariati Kombëtar EITI ka përfshirë në termat e Referencës për Administratorin e Pavarur edhe elemente të rinj si: Monitorimi i Sigurisë në punë dhe të jetës së punonjësve në sektorin minerar dhe hidrokarbur; Vënia e theksit tek të ardhurat e Pushteteve Lokale dhe komuniteteve për përfitimet nga aktivitetet minerare në rajonin e tyre, si dhe impaktin Mjedisor dhe Social të këtyre aktiviteteve; Angazhimin e Administratorit të Pavarur për organizimin e workshop-eve informuese për materialet e përgatitura në funksion të Raportit zyrtar vjetor EITI.

VEPRIMET KORRIGJUESE TË DALA NGA PROÇESI I VALIDIMIT

Grupi Ndërinstitucional i Punës (MSG) dhe Sekretariati Kombëtar EITI pasi u njoh me dokumentin mbi Veprimet Korrigjuese, të dala nga proçesi i Validimit për Shqipërinë, diskutuan dhe miratuan Planin e Veprimit për hapat që do ndiqen në vazhdimësi. Një pikë e rëndësishme ishte diskutimi mbi përmirësimin e formatit të Funksionimit të MSG-së, rikonfigurimi i anëtarëve të këtij grupi pune dhe përfshirja e Albpetrol si anëtar me të drejta të plota në MSG, marrë në konsideratë peshën e rëndësishme që ka Albeptrol në raportimin konform Standartit EITI, në sektorin Hidrokarbur.

AKTIVITETET E KOMUNIKIMIT DHE NDËRGJEGJËSIMIT NË 2018 *SHKURTIMISHT*

TAKIME PËR BASHKËPUNIM

Gjatë vitit 2018, Drejtuesi i Sekretariatit Kombëtar EITI ka organizuar takime me Organizata Ndërkombëtare dhe Lokale për të mbështetur dhe fuqizuar Iniciativën EITI në Shqipëri.

COMPLIANCE ADVISOR OMBUDSMAN (CAO) DHE PUSHTETET /KOMUNITETET LOKALE PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRVESHJEVE ME BIZNESET

20 Shtator 2018

Kjo tryezë e rrumbullakët e mbajtur në Tiranë ndihmoi në adresimin e problematikave që shfaqen në komunitetet tona, si dhe në proçesin negociues për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet komuniteteve dhe bizneseve që veprojnë në zonat me industri nxjerrëse. Drejtuesi i Sekretariatit Kombëtar EITI deklaroi se Transparenca ngushton hapësirën e korrupsionit, ndërsa qeverisja e mirë shkon përtej thjesht Transparencës.

Link: http://www.albeiti.org/takim-mbi-problematikat-dhe-sfidat-e-zgjidhjes-se-mosmarrveshjeve-ndermjet-bizneseve-dhe-komuniteteve/

BASHKËPUNIM ME PREZENCËN E OSBE NË SHQIPËRI

26 Qershor 2018

Prezenca e Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë në Shqipëri ka mbështetur aktivitetin EITI në Shqipëri dhe në 2013-2014. Mbështetja nga Prezenca e OSBE-së shihet si një faktor shumë i rëndësishëm për zgjerimin e aktiviteteve të Sekretariatit Kombëtar.

Link: http://www.albeiti.org/per-nje-platforme-bashkepunimi-ndermjet-sekretariatit-kombetar-eiti-dhe-organizates-per-siguri-dhe-bashkepunim-ne-evrope-prezenca-ne-shqiperi-osbe/

BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONET ZYRTARE TË KOSOVËS

9 Mars 2018

Sekretariati Kombëtar EITI dhe përfaqësuesit e Komisionit të Panvarur për Minierat dhe Mineraret e Kosovës shprehën interesin e tyre të përbashkët në lehtësimin e proçesit të anëtarësimit të Kosovës në Nismën EITI duke ndjekur përvojën Shqiptare.

Link: http://www.albeiti.org/takimin-zyrtar-ne-komisionin-e-pavarur-per-minierat-dhe-mineralet-kpmm-te-kosoves/

BASHKËPUNIM ME FIAA

13 Shkurt 2018

Një takim i përbashkët midis EITI dhe FIAA, përforcoi përkushtimin për të rritur nivelin e bashkëpunimit që do të përmirësojë angazhimin e biznesit në sektorin nxjerrës.

Link: http://www.albeiti.org/takim-me-fiaa-lidhur-me-aktivitetin-e-sekretariatit-eiti-ne-shqiperi/

BASHKËPUNIM ME AMBASADËN ZVICERIANE

8 Shkurt 2018

Ky takim nënvizon mbështetjen e qeverisë Zviceriane për Shqipërinë dhe angazhimin e saj për të punuar me EITI në Shqipëri duke identifikuar prioritetet dhe fushat ku mund të kontribuojnë, në mënyrë specifike në rritjen e transparencës në përdorimin dhe qeverisjen e mirë të burimeve natyrore në Shqipëri.

Link: http://www.albeiti.org/takim-i-drejtorit-te-sekretariatit-albeiti-z-ardit-kamberi-me-zv-ambasadorin-e-konfederates-se-zvicres-z-philipp-keller/

KONFERENCA: RAPORTI EITI 2016

28 Shkurt 2018

Publikimi i Raportit Vjetor EITI 2016, ka për qëllim nxitjen e Transparencës në Qeverisjen e Burimeve Natyrore në Shqipëri. Publikimi i të dhënave të Raportit Zyrtar Vjetor EITI 2016, finalizon aktivitetin vjetor të Sekretariatit Kombëtar EITI, me fokus në promovimin e Transparencës dhe Mirëadministrimin e Burimeve natyrore të vendit, fryt edhe i bashkëpunimit me MSG dhe Grupet e Interesit.

Proçesi i përgatitjes së Raportit EITI 2016 inkludoi: të Gjitha shoqëritë që operojnë në kërkimin dhe prodhimin e Naftës dhe gazit; 120 shoqëri Minerare (me kontribut me mbi 80 % të prodhimit minerar total), si dhe 12 shoqëri të sektorit Hidro-Energjitik.

Link: http://www.albeiti.org/konference-per-prezantimin-e-raportit-eiti-2016-dhe-promovimin-e-transparences-ne-aktivitetin-e-shfrytezimit-te-burimeve-natyrore-ne-shqiperi/

KRONIKA

4-5 Janar 2018

5 Mars 2018

Fokusi kryesor i kronikës së lajmeve në TV SCAN ishte të tregonin gjetjet më të rëndësishme të Raportit EITI 2016 në drejtim të aktivitetit industrial, zbulimit financiar, kuadrit ligjor dhe kontributit në buxhetin e shtetit.

Intervistë në studio me Drejtuesin e Sekretariatit Kombëtar të EITI nga gazetari i SCAN TV.

Links: http://www.scan-tv.com/prodhimi-naftes-akbn-per-9-mujorin-u-prodhuan-rreth-730-mije-ton/

http://www.scan-tv.com/te-ardhurat-nga-renta-ndikim-pozitiv-rritja-e-cmimeve-ne-tregun-nderkombetar-2/

https://www.youtube.com/watch?time_continue=2&v=XLWjQ0qfaVA

EDITORIALE

18 Janar 2018

13 Shkurt 2018

Krijimi dhe publikimi i një editoriali të përqëndruar kryesisht në Standardin EITI si pikë referimi për investitorët e brendshëm dhe të huaj kur është fjala për industritë nxjerrëse. Editorialet përshkruajnë gjithashtu se sa vlerë financiare ka një sektor kur pasohet nga një transparencë.

Links: http://www.mapo.al/eiti-ne-shqiperi-rekomandimet-kryesore-per-industrine-nxjerrese/

http://www.albeiti.org/eiti-ne-shqiperi-rekomandimet-kryesore-per-industrine-nxjerrese-nga-enio-civici/

http://www.mapo.al/transparenca-ne-sherbim-te-mirembajtjes-se-burimeve-natyrore/

http://www.albeiti.org/transparenca-ne-sherbim-te-mirembajtjes-se-burimeve-natyrore/

http://esc.albaniaenergy.org/sq/2018/01/21/esc_adriatic-2/transparenca-ne-sherbim-te-mirembajtjes-se-burimeve-natyrore-nga-enio-civici/

PJESËMARRJE NË KONFERENCA

Pjesëmarrja në Konferencë shihet nga Sekretariati Kombëtar EITI si një hap i rëndësishëm për promovimin dhe implementimin e Transparencës në Industrinë Nxjerrëse, si dhe për të shkëmbyer përvojën me organet e tjera.

TAKIMI I 11-të PLENAR NDËRKOMBËTAR PËR DIALOGUN MBI POLITIKAT E ZHVILLIMIT TË BURIMEVE NATYRORE –OECD

12-13 Dhjetor

Dialogu mbi Politikat e Zhvillimit të Burimeve Natyrore është një proçes ndërqeveritar shumëvjeçar në shkëmbimin e praktikave dhe bashkërendimit ndërmjet vendeve partnere të OECD-së që prodhojnë minerale, naftë dhe gaz, mbi përdorimin e burimeve natyrore për transformimin strukturor dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Me ftesë të organizatorëve përfaqësuesit e Sekretariatit Kombëtar EITI Shqipëri morën pjesë për herë të parë në këtë event.

Link: http://www.albeiti.org/sekretariati-eiti-pjesemarres-zyrtar-ne-eventin-e-oecd-te-takimit-te-11-te-plenar-nderkombetar-per-dialogun-mbi-politikat-per-zhvillimin-bazuar-ne-burimet-natyrore/

15th JUBILEE VIENNA ECONOMIC FORUM- VIENNA FUTURE DIALOGUE 2018

19 Nëntor 2018

Sekretariati Kombëtar EITI Shqipëri u ftua dhe mori pjesë në këtë Forum ku u diskutua mbi prioritetet e OSBE dhe vendeve anëtare në sektorin e sigurisë së burimeve energjitike dhe interkoneksionit për një zhvillim të qëndrueshëm.

Link: http://www.albeiti.org/forumi-ekonomik-i-vjenes-dialogu-i-te-ardhmes-ekonomia-takon-politiken-15th-jubilee-vienna-economic-forum-vienna-future-dialogue-2018/

TAKIMI I BORDIT EITI DHE KONFERENCA NDËRKOMBËTARE PËR PUBLIKIMIN E PRONARËVE PËRFITUES

31 Tetor-2 Nëntor 2018

EITI Shqipëri u ftua të merrte pjesë në Konferencën e 41-të Bordit EITI dhe Konferencën për Përfituesit Realë (BO) në Dakar, Senegal. EITI Shqipëri është fokusuar në Publikimin e Përfituesve Realë si një pjesë qendrore e veprimtarisë së tij, duke përfshirë standartet ndërkombëtare në hartimin dhe finalizimin e legjislacionit në lidhje me Transparencën në Industrinë Nxjerrëse dhe përgatitjen e Regjistrit Publik mbi Përfituesit Realë në koordinim me disa institucione të të njëjtit spektër.

Link: http://www.albeiti.org/takimi-i-bordit-nderkombetar-eiti-dhe-konferenca-nderkombetare-per-beneficial-ownership-disclosure-dakar-senegal-2/

ZBATIMI I DIMENSIONIT EKONOMIK DHE MJEDISOR

15-16 Tetor 2018

OSBE organizoi në Vjenë një takim të nivelit të lartë ku u trajtuan sfidat strategjike që lidhen me sektorin e energjisë, se si bashkëpunimi në këtë sektor mund të çojë në sigurinë politike, bashkëpunimin rajonal për të siguruar tregje më atraktive, krijimin e vendeve të punës, mirëqenien sociale dhe zgjidhjen e konflikteve rajonale. Sekretariati Kombëtar EITI mori pjesë në këtë aktivitet dhe aktualisht po punon për të krijuar një platforme të qëndrueshme bashkëpunimi në fushat me interes të ndërsjellë me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri.

Link: http://www.albeiti.org/sekretariati-eiti-shqiptar-merr-pjese-ne-takimin-e-nivelit-te-larte-te-osbe-ne-viene-per-implementimin-e-dimensionit-ekonomik-dhe-mjedisor-2018-2/

EVENT MBI RRITJEN E ROLIT TË SHOQËRISË CIVILE, KIEV, UKRAINË

3-5 Korrik 2018

Praktika Globale të Bankës Botërore në Industrinë Nxjerrëse dhe Sekretariati Ndërkombëtar EITI organizuan një event për rritjen e rolit të Shoqërisë Civile në proçesin EITI dhe angazhimin e MSG. Drejtuesi i Sekretariatit Kombëtar EITI prezantoi aktivitetin e EITI-t në Shqipëri dhe zhvilloi takime me kolegë nga vendet pjesëmarrëse dhe BB.

Link: http://www.albeiti.org/kievukraine-event-per-iniciativen-eiti-organizuar-nga-banka-boterore-dhe-sekretariati-nderkombetar-eiti/

OTC-OIL AND GAS OFFSHORE TECHNOLOGY 2018

30 Prill - 3 Maj 2018

Me ftesë të Ambasadës Amerikane në Tiranë, Drejtuesi i Sekretariatit Kombëtar EITI mori pjesë në këtë konferencë ndërkombëtare në Houston të Teksasit, SHBA. Konferenca trajtoi rëndësinë strategjike specifike të sigurisë energjitike kombëtare, rajonale dhe globale në kontekstin e sfidave aktuale ekonomike, politike, sociale dhe mjedisore.

Link: http://www.albeiti.org/konferenca-nderkombetare-otc-oil-and-gas-offshore-technology-2018-30-prill-3-maj-2018/

TAKIME NË NIVEL LOKAL

Takimet me autoritetet lokale luajnë një rol shumë të rëndësishëm për ecurinë e implementimit të iniciativës EITI. Gjatë vitit 2018, Sekretariati Kombëtar EITI organizoi disa takime në Bashki dhe komunitete në zonat me industri nxjerrëse.

BASHKIA ROSKOVEC

12 Nëntor 2018

Bankers Petroleum është kompania më e madhe e prodhimit të naftës në Shqipëri që gjendet dhe mbikëqyret nga Bashkia e Roskovecit. Sekretariati Kombëtar EITI e sheh rolin e Strukturës Lokale shumë të rëndësishme në përmirësimin e mjedisit social dhe ekonomik.

Link: http://www.albeiti.org/promovimi-i-transparences-eiti-ne-nivel-lokal-bashkia-roskovec/

BASHKIA PUKË DHE FUSHË ARRËZ

7 Shtator 2018

Kompanitë minerare që operojnë kryesisht në nxjerrjen e bakrit, kromit, kaolinëve dhe hidroçentraleve koncensionare të vogla, veprojnë në territorin e këtyre Bashkive. Takimet me autoritetet lokale u përqëndruan në rëndësinë e Transparencës në qeverisjen e mirë të burimeve natyrore, si mjeti dhe politika më e mirë për një klimë biznesi të qëndrueshme dhe atraktive.

Link: http://www.albeiti.org/takime-me-drejtues-te-bashkive-puke-dhe-fushe-arrez-mbi-aktivitetin-eiti-dhe-problemet-lidhur-me-perfitimet-nga-industria-nxjerrese-ne-keto-zona/

BASHKIA POGRADEC

5 Qershor 2018

Aktualisht janë 22 aktivitete minerare, kryesisht në minierat e mineraleve të kromit dhe hekur-nikelit dhe 15 subjekte të hidroçentraleve koncensionare të vogla, janë në territorin e kësaj komune. Në takim u përcaktua rëndësia e përfshirjes reale të biznesit në proçesin e EITI, në bashkëpunim me Institucionet Qëndrore, Qeverisjen Lokale dhe Shoqërinë Civile për të promovuar transparencën në menaxhimin e burimeve natyrore.

Link: http://www.albeiti.org/takim-me-perfaqesues-te-pushtetit-lokal-dhe-te-bizneseve-ne-sektorin-minerar-ne-pogradec/

PANAIRE

PANAIRI NDËRKOMBËTAR I TIRANËS

23 Nëntor 2018

Pjesëmarrja në Panairin Kombëtar tregon angazhimin që Sekretariati Kombëtar i EITI ka ndërmarrë për të promovuar Iniciativën EITI duke krijuar kështu bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare mes grupeve ekonomike dhe tregtare të interesit.

Link: http://www.albeiti.org/eiti-shqiperi-rrit-bashkepunimin-me-grupet-e-interesit/

PANAIRI MBI INVESTIMET RAJONALE NË ENERGJI 2018

5-6 Tetor 2018

Vizitorët nga publiku dhe biznesi i gjerë u njohën me punën dhe rolin e Iniciativës EITI në promovimin e investimeve të huaja në vend, duke marrë informata zyrtare, koherente dhe të çertifikuara në bazë të Standardit Ndërkombëtar EITI.

Link: http://www.albeiti.org/eiti-shqiptar-merr-pjese-ne-panairin-rajonal-per-investimet-ne-energjine-elektrike/

MBLEDHJET E MSG

Gjatë vitit 2018, u mbajtën katër (4) mbledhje të MSG dhe të gjitha çështjet e vendosura në rendin e ditës janë diskutuar dhe miratuar nga anëtarët e MSG. Axhenda e takimeve, Minutat e Takimit, Listë Prezenca dhe Vendimet e MSG gjenden në faqen zyrtare të internetit të EITI Shqipëri.

21 QERSHOR *http://www.albeiti.org/takim-me-grupin-nderinstitucional-te-punes-per-diskutimin-e-termave-te-references-per-aktivitetet-kryesore-eiti-si-dhe-progres-raportin-vjetor/*

15 MAJ *http://www.albeiti.org/takim-i-msg-dhe-sekretariati-kombetar-eiti-lidhur-me-planet-e-veprimit-per-optimizimin-e-corrective-actions-te-dala-nga-procesi-nderkombetar-i-validimit/*

28 MARS *http://www.albeiti.org/mbledhje-e-grupit-nderinstitucional-i-punes-eiti-msg/*

7 DHJETOR *http://www.albeiti.org/commodity-trading-dhe-beneficial-ownership-ne-fokusin-e-aktivitetit-eiti/*

WORKSHOP PËR TREGTIMIN E LËNDËVE TË PARA (COMMODITY TRADING)

29 Qershor 2018

Kërkesa e EITI 4.2 kërkon të sigurojë transparencën e nevojshme, sa kompani shtetërore në vendet e EITI përfitojnë nga vëllimet e shitura dhe të ardhurat e marra nga nafta, gazi dhe mineralet dhe sa këto të ardhura transferohen në buxhetin e shtetit. Përfaqësuesit e MSG, institucionet shtetërore, përfaqësuesit e Albpetrol dhe grupet e interesit të pranishëm në seminar diskutuan në një formë konstruktive rreth gjetjeve të Raportit paraprak në mënyrë që të optimizohen konkluzionet dhe rekomandimet që do të reflektohen nga Deloitte në Raportin Përfundimtar.

Link: http://www.albeiti.org/workshop-per-transaksionet-e-lendeve-te-para-nga-shogerite-me-kapital-shteteror-commodity-trading/

VLERËSIMI I PERFORMANCËS KUNDREJT OBJEKTIVAVE DHE AKTIVITETEVE TË PËRCAKTUARA NË PLANIN E PUNËS TË SEKRETARIATIT EITI SHQIPËRI

NË PËRPUTHJE ME KËRKESËN 1.5 DHE KËRKESËN 7.4. (a)(iv)

OBJEKTIVI RAPORTI EITI 2017 dhe 2018

Për shkak të vonesava objektive të fondeve të financuara nga BB, raporti EITI për vitet 2017 dhe 2018 ende nuk ka filluar dhe është në proçedurë prokurimi.

OBJEKTIVI VALIDIMI

Gjatë vitit 2018 Shqipëria ka qenë në proçesin e Validimit të II i cili ka vazhduar edhe gjatë vitit 2019 me Misionin e Validimit, i cili ka shqyrtuar gjithë hapat e ndërmarra nga Shqipëria për Corrective Actions të lëna nga Validimi parë. Në fund të Majit 2019 është marrë Raporti Final i Vlerësimit nga Validuesit dhe në datë 17 qershor 2019 është marrë vendimi nga Bordi Ndërkombëtar EITI për Validimin e II të Shqipërisë.

OBJEKTIVI SHQYRTIMI LIGJOR DHE RREGULLATOR

Gjatë vitit 2018, është punuar me shqyrtimin ligjor dhe rregullator dhe në këtë kuadër janë draftuar Termat e Referencës për Beneficial Ownership. Këto ToRs janë diskutuar, komentuar dhe kanë marrë miratimin e MSG-së, Sekretariatit Ndërkombëtar EITI dhe Bankës Botërore.

Për shkak të vonesava objektive të fondeve të financuara nga BB, kjo proçedurë është në fazë prokurimi.

OBJEKTIVI ZGJERIMI I KAPACITETEVE EITI

Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të cilat janë përmendur hollësisht më sipër, në paragrafin e aktiviteteve.

OBJEKTIVI AKTIVITETE KOMUNIKIMI

Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar aktivitete të shumta komunikimi të cilat janë përmendur hollësisht më sipër, në paragrafin e aktiviteteve.

VLERËSIMI I PERFORMANCËS KUNDREJT KËRKESAVE EITI *NË PËRPUTHJE ME KËRKESËN 7.4. (a)(ii)*

KËRKESAT	PROGRESI
KËRKESA EITI 1 **Mbikëqyrja nga Grupi Ndërinstitucional i Punës** 1.1Angazhimin e qeverisë 1.2 Angazhimin e kompanive 1.3 Angazhimin e shoqërisë civile 1.4 Grupi Ndërinstitucional i Punës 1.5 Plani i Punës	*MSG në Shqipëri është përfshirë në mënyrë aktive në zbatimin e EITI. Shqipëria publikuar raporte të EITI sipas afateve të përcaktuara. Anëtarët MSG janë të angazhuar në zbatimin e EITI, sipas sektorit që ata mbulojnë.* *Institucionet shtetërore, pjesë përbërëse e MSG, kanë treguar angazhim të lartë duke vënë në dispozicion të Iniciativës EITI strukturat dhe burimet e tyre njerëzore për Raportimin EITI.* *Për arsye subjektive duke përjashtuar vetëm një numër të vogël të vonesave, kompanitë kanë treguar përkushtim ndaj proçesit të raportimit dhe kanë luajtur një rol kyç në publikimin e pagesave të tyre dhe Qeveria në publikimin e të ardhurave të përfituara nga kompanitë nxjerrëse. Gjithashtu, qeveria ka vazhduar të financojë zbatimin e EITI nga buxheti kombëtar.* *Gjetja e një gjuhe gjithëpërfshirëse dhe ndërtimi i një bashkëpunimi konstruktiv e bëjnë punën e MSG Shqipëri produktive. Sidoqoftë, duhet të përmendim vakumin që ndodhi me strukturën e MSG duke mos zëvendësuar disa vende nga anëtarët e OSHC-ve që me dëshirë kanë dhënë dorëheqjen.* *Anëtarët e MSG nga Shoqëria Civile kanë treguar përkushtim ndaj Nismës EITI duke qenë të zëshëm në takimet për çështje të ndryshme. Ajo që u pa si shqetësim dhe për të cilën u punua dhe u realizua në fillim të vitit 2019 ishte mungesa dhe jo përmbushja e dy vendeve të zbrazëta të këtij grupi në MSG të EITI.* *EITI Shqipëri, pavarësisht se ka hasur në mungesë të fondeve, për shkak të arsyeve objektive të vonesës të financimit të Bankës Botërore, nuk e ka ndaluar punën për të arritur me sukses objektivat e dhe në përmbushjen e aktivitetet të përcaktuara në planin e punës.*
KËRKESA EITI 2 **Kuadri ligjor dhe institucional, duke përfshirë alokimin e kontratave dhe**	*Aktualisht, EITI Shqipëri po aprovon projektligjin "Për transparencën e aktiviteteve*

licencat 2.1 Kuadri ligjor dhe regjimi fiskal 2.2 Shpërndarja e licensave 2.3 Regjistri i licensave 2.4 Kontratat 2.5 Pronarët Përfitues 2.6 Pjesëmarrja e shtetit	*të industrive nxjerrëse dhe përdorimin e burimeve natyrore në Republikën e Shqipërisë". Qëllimi i këtij ligji është nxitja dhe sigurimi i rritjes së transparencës në aktivitetet e industrisë nxjerrëse dhe përdorimit të burimeve natyrore përmes zbatimit të standardeve ndërkombëtare të EITI, për të përmirësuar kuadrin ligjor për raportin e EITI dhe duke e harmonizuar atë me standardin EITI. Gjithashtu, ky Projektligj përfshin dispozita ligjore për publikimin e Pronarëve Përfitues.* ***Alokimet e licencave.*** *Shqipëria ka bërë publike zonat e lira të naftës dhe kompanitë e interesuara hyjnë në negociata me qeverinë shqiptare. Licensat minerare ofrohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në Ligjin Nr 10 304 datë 15.07.2010" Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar". Programi vjetor minerar,miratuar me V.K.M., percakton zonat minerare konkuruese dhe zonat e lira. Për zonat minerare konkuruese subjektet e interesuara i nënshtrohen një konkurimi publick ku vleresimi i fituesit bëhet mbi bazën e kritereve të përcaktuara me ligj. Për zonat e hapura licensa i jepet subjektit të interesuar i cili plotëson kushtet e lejimit sipas parimit - i pari në kohë, i pari në të drejta.* *Publikimi i Planit vjetor minerar dhe të gjitha proçedurave konkuruese bëhet në Agjensinë e Prokurimit Publik dhe në faqen zyrtare të MIE.* *Sipas raportit EITI 2016 dhe në përputhje me kërkesat 2.4.b, Shqipëria ka bërë përparim në publikimin e* ***kontratave*** *të reja të naftës dhe të të gjitha termave të koncesionit të hidroçentraleve. Projektligji i EITI propozon publikimin e kontratave. Të gjitha kontratat e koncesionit miratohen me V.K.M dhe nënshkruhen nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.* *Pas nënshkrimit të kontratës, operatori harton një plan të hollësishëm të zbatimit. Përpara se të miratohet, ky plan përsëri i nënshtrohet kontrollit teknik të shtetit. Marrëveshjet e naftës dhe gazit u ndanë përmes proçedurave ad hoc të negociatave deri në gusht 2013. Informacioni mbi të licensuarit dhe operacionet e përbashkëta publikohen në faqen e internetit të MIE-së. Ndërtimi i*

	termocentraleve u nënshtrohet 10-20 lejeve nga organe të ndryshme rregullatore, duke përfshirë: lejen mjedisore (vjetore), lejet e ndërtimit (para ndërtimit), lejen për shfrytëzimin e burimeve ujore (vjetore), licencën për prodhimin e energjisë (para fillimit të prodhimit), leje për t'u lidhur me rrjetin e transmisionit të energjisë etj. ***Regjistri i liçencave** është i disponueshëm publikisht në faqen e internetit ALBEITI: www.albeiti.org Ky regjistër rifreskohet çdo 6 muaj. Gjithashtu Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës ka publikuar një regjistër të liçencave minerare në linkun: http://www.infrastruktura.gov.al/lejet-minerare-ekzistuese* *Në kontekstin e legjislacionit shqiptar **Pronar Përfitues** perkufizohet në Ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar, neni 2 / pika 12. si personi fizik, që zotëron ose kontrollon i fundit një klient dhe/ose personi, për llogari të të cilit kryhet një transaksion. Këtu përfshihen edhe ata persona, të cilët ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv ndaj një personi juridik. Kontroll i fundit efektiv është marrëdhënia, në të cilën një person:* *a) zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të paktën 25 për qind të aksioneve ose të votave të një personi juridik;* *b) i vetëm zotëron të paktën 25 për qind të votave të një personi juridik në bazë të një marrëveshjeje me ortakët ose me aksionarët e tjerë;* *c) përcakton de facto vendimet e marra nga personi juridik;* *d) kontrollon në çdo lloj mënyre zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së administratorëve të personit juridik.* *Ky ligj përkufizon gjithashtu "Personat e ekspozuar politikisht" si personat, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarimin e pasurive të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", përfshirë anëtarët e familjes apo personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi, me përjashtim të nëpunësve të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Në këtë kategori përfshihen edhe individët, të cilët kanë pasur*

	ose kanë funksione të rëndësishme në një qeveri dhe/ose në një shtet të huaj, si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, politikanë të lartë, zyrtarë të lartë të qeverisë, të gjykatave ose të ushtrisë, drejtues të lartë të kompanive shtetërore, zyrtarë të rëndësishëm të partive politike, përfshirë anëtarët e familjes apo personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi." *Në kuadrin e përpilimit të raportit EITI 2016, MSG i kërkoji subjekteve raportuese dhe autoritetit kontarktues, MEI-it të raportojë informacion për pronarët e dobishëm sipas perkufizimeve të standartit EITI. MEI konfirmon se sot Ministria nuk disponon një regjistër sipas kërkesave të standartit EITI. Subjektet e licensuara gjithashtu nuk ishin gati për këtë raportim. Shumica e subjekteve zgjodhi të mos e plotësoj formularin duke komentuar se pronësia mbi shoqerinë paraqitej në regjistrin e QKR. Një pjesë e mirë e tyre u shprehën se nuk kishte detaje të zinxhirit të plotë të pronësisë. Vetëm 17 raportuan pronarët e shoqërisë. Në të gjitha rastet pronarët e listuar ishin të njëjtë me çfarë ishte paraqitur në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit* ***Pjesëmarrja e shtetit*** *a) Subjektet shtetërore në Shqipëri përcaktohen me nenin 213 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për sipërmarrësit dhe subjektet tregtare", si subjekte tregtare të zotëruara dhe të kontrolluara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga qeveria qendrore ose qeveria lokale, kurse kontrolli fuqia për të qeverisur aktivitetet e subjekteve tregtare. Ky ligj sugjeron që në rastet e çështjeve që kërkojnë shumicë të kualifikuar, Aksionerët. Përkufizimi i NSH-ve shpjegohet në Raportin EITI 2016 dhe MSG-ja është pajtuar me këtë përkufizim gjatë proçesit të raportimit EITI.* *b) Niveli i pronësisë së NSH-ve është shpjeguar në Raportin EITI 2016.*
KËRKESA EITI 3 **Kërkim-Zbulimi dhe prodhimi** 3.1 Kërkim-Zbulimi 3.2 Prodhimi 3.3 Eksportet	*Të gjitha të dhënat e* kërkim-zbulimit*, prodhimit dhe eksportit janë të dokumentuara në Raportin e EITI Albania dhe gjenden të publikuara në faqen e internetit* www.albeiti.org

KËRKESA EITI 4

Mbledhja e të ardhurave

4.1 Publikim i detajuar i taksave dhe të ardhurave
4.2 Shitja e pjesës së shtetit të prodhimit ose të ardhurave të tjera të mbledhura në natyrë
4.3 Dispozitat e infrastrukturës dhe marrëveshjet e shkëmbimit
4.4 Të ardhurat nga transporti
4.5 Transaksionet që kanë të bëjnë me ndërmarrjet shtetërore
4.6 Pagesat në nivel kombëtar
4.7 Niveli i ndarjes
4.8 Koherenca e të dhënave
4.9 Cilësia dhe siguria e të dhënave

Publikim i detajuar i taksave dhe të ardhurave *Sistemi i taksave që zbatohet në Shqipëri për sektorin e industrisë nxjerrjese është e njëjtë që zbatohet për ekonominë e gjithë vendit, TVSH, taksat e fitimit, dividentët + renta, bonuse dhe pagesa të tjera të rëndësishme dhe përfitime materiale për qeverinë. Qiraja minerare nga qeveria shihet si një taksë për zhvillimin e kësaj zone. Për të dhënë impuls ose zhvillim në industrinë e përpunimit në vend, qeveria zvogëloi rentën për kromit e përpunuar (ferrochrome) nga 6 në 3 për qind. Raporti i EITI tregon një përmbledhje gjithëpërfshirëse tatimore të mbledhur nga qeveria për vitin 2016.*

Shitja e pjesës së shtetit të prodhimit ose të ardhurave të tjera të mbledhura në natyrë *Në Raportin EITI 2016 janë shpalosur të hyrat e mbledhura në natyrë nga Albpetrol.*

Marrëveshjet për Sigurimin e Infrastrukturës *Raporti i EITI 2016 përfshin një vlerësim të zbatueshmërisë së dispozitave të infrastrukturës dhe aranzhimeve të këmbimit në sektorët e naftës dhe minierave, të përshkruara respektivisht në kapitullin 3 dhe 4.*

Të ardhurat nga transporti *Shteti Shqiptar nuk merr taksë tranziti. Tubacionet e Albpetrol nuk janë funksionale. Dy tubacione për transportin e naftës së papërpunuar lidhin terminalin e naftës së ARMOs në Vlorë me rafineritë e Fierit dhe Ballshit si dhe dy rafineritë mes tyre. Të dy tubacionet janë jashtë funksionit për shkak të vjetërimit. Në total, rrjeti i tubacioneve të naftës ka një gjatësi prej 188 km dhe kapacitet prej 2.5 milion ton në vit.*

Trans Adriatic Pipeline (TAP) AG është një bashkim i disa shoqërive ndërkombëtare themeluar me qëllim planifikimin, zhvillimin dhe ndërtimin e gazsjellësit natyror TAP. Qeveria shqiptare ka hyrë në bisedime me koncorciumin e TAP për vendosjen e një takse Tranziti. TAP është aktualisht kontribuesi më i madh i investimeve të huaja direkte në vend. Që nga fillimi i ndërtimit deri në fund të vitit 2016, TAP ka investuar rreth 1.5 miliardë euro, nga këto 1 miliard euro janë investuar në 2016. Siç është vendosur në Marrëveshjen

	e Qeverisë Pritëse midis TAP dhe Qeverisë Shqiptare, TAP do të shpenzojë 14 milionë euro në infrastrukturë dhe investime të tjera në dobi të shoqërisë civile dhe komuniteteve. ***Jonian Adriatic Pipeline (Projekti IAP)*** *Qeveria Shqiptare ka promovuar mundesinë e realizimit të projektit Adriatic Pipeline (IAP), me qëllim që të krijojë Infrastrukturën e përbashkët Rajonale për të shfrytëzuar gazin Kaspik në tregjet e vendeve si Shqipëria, Mali i Zi, Kroacia* ***Infrastruktura e gazit në Shqipëri*** *Qeveria Shqiptare miratoi ligjin për sektorin e gazit natyror Nr.102 / 2015 "Për sektorin e gazit" në mars të vitit 2015. Ky ligj do të qeverisë zhvillimin e infrastrukturës për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit në Shqipëri.* *Në vitin 2016, Qeveria themeloi Operatorin Shqiptar të Transmetimit të Gazit (Albgaz Sh.a.) dhe prezantoi draft master-planin për rrjetin e shpërndarjes së gazit. Ky studim kushtoi rreth 1.1 milion euro dhe u financua nga BE.* *Drafti i master-planit analizon përdorimin e gazit në industri, transport dhe konsumatorët familjarë etj. TAP do të jetë burimi kryesor i furnizimit me gaz, ndjekur nga Ionian-Adriatic Pipeline (IAP) dhe rezerva të tjera potenciale të vendit. Drafti konsideron mundësinë e lidhjes së Kosovës dhe Maqedonisë me rrjetin Shqiptar të shpërndarjes së gazit. Gjithashtu, plani konsideron dhe mundësinë e depozitimit të gazit në nëntokën e Divjakës, në Dumre.* *Sipas studimit, konsumi vendas i gazit parashikohet të jetë rreth 2,167 milion m3 në vitin 2040 (duke përfshirë bujqësinë dhe transportin). Në të njëjtin vit, përdorimi potencial i gazit për prodhimin e energjisë elektrike vlerësohet të jetë rreth 770 milion m3, ndërsa përdorimi potencial i gazit në proceset e rafinerimit të naftës parashikohet të jetë 89 milion m3.* ***Transaksionet që kanë të bëjnë me ndërmarrjet shtetërore.*** *Albpetrol i paguan taksa qeverisë, siç zbatohet për të gjitha kompanitë komerciale të naftës dhe dividentët në cilësinë e aksionarit të vetëm të kompanisë. Të dy Albpetrol dhe MIE njoftuan se nuk ka marrëveshje të posaçme që rregullojnë transferimet nga Albpetrol në*

	Qeveri dhe anasjelltas. Albpetrol ka qenë fitimprurës deri më tani, pavarësisht bazës së madhe të kostos së punonjësve. Financat e Albpetrol tregojnë rezultate të luhatshme të fitimit. Të ardhurat rrjedhin kryesisht nga shitja e naftës në dispozicion. Fitimet operative në vitin 2016 janë 62% më të ulëta se në vitin 2013. Kjo rënie e ndjeshme ndikohet nga rënia e çmimeve të naftës dhe sasisë së naftës, të cilat rrjedhin nga prodhimi i naftës i vetë Albpetrol dhe pjesa e vajit të mbledhur nga PSA të dhëna për zonat nën marrëveshjen e licencës së Albpetrol. Në vitin 2015 dhe 2016, Albpetrol arriti të reduktojë kostot e tij të personelit të cilat përbëjnë një komponent kyç të kostos. Bazuar në informatat e shpalosura në pasqyrat e saj financiare, Albpetrol nuk ka marrë, as nuk ka dhënë hua për Qeverinë deri tani. Albpetrol mban llogaritë e arkëtueshme tregtare të konsiderueshme nga ARMO në shumën 12 miliardë lekë në fund të 2016. ***Pagesat lokale*** *Renta mblidhet nga shitjet e tatueshme të naftës, gazit dhe mineraleve dhe regjistrohen në Buxhetin e Shtetit. Sipas Ligjit për taksat kombëtare nr. 9975, datë 28 korrik 2008, ndryshuar, një pjesë e tatimit mbi të drejtën e rentës do të ndahet për secilën njësi të qeverisjes vendore ("NJQV") në proporcion me kontributin e tyre në prodhimin e brendshëm të naftës, gazit dhe minerareve.* ***Cilësia dhe siguria e të dhënave,Standardet e Aplikuara të Kontabilitetit*** *Dispozitat aktuale rregullatore në Shqipëri kërkojnë që subjektet e përfshira të zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) ose Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (IAS), të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit për shpenzimet e kontabilitetit dhe raportimi ligjor .* ***Standardet e Auditimit të Aplikuara*** *Të gjitha subjektet, përfshirë shoqëritë aksionare pjesëmarrëse ("SHA") dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar ("SHPK") janë subjekt i auditimit ligjor, duke përjashtuar ato SHPK të klasifikuara si njësi më të vogël.* *LIGJ-in Nr.10 091, datë 5.3.2009 "PËR AUDITIMIN LIGJOR, ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË AUDITUESIT LIGJOR DHE TË KONTABILISTIT TË MIRATUAR" (ndryshuar me ligjin nr.10 297, datë 8.7.2010, nr. 47/2016, datë 28.4.2016, konkretisht. Neni 41, Personat*

	juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare (ndryshuar shkronja "c", me ligjin nr. 47/2016, datë 28.4.2016) Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese: *a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar;* *b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit;* *c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:* *I - totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;* *ii - shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;* *iii - ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.* ***Sqarojmë se subjektet minerare që raportojnë në Raportin EITI janë përgjithësisht shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe një pjesë e konsiderushme e tyre nuk plotësojnë kushtin që i detyron të auditojnë bilancet e tyre nga ekspert të pavarur.*** ***Niveli i ndarjes*** *paraqitet në Shtojcën 1, 2, 3 të Raportit EITI 2016.* ***Afati kohor i të dhënave*** *Raporti i EITI 2016 është prodhuar dhe publikuar në përputhje me kërkesat e EITI, më 15 shkurt 2018.* ***Koherenca e të dhënave*** *Raporti EITI 2016 ofron një vlerësim të proçedurave të sigurimit të kryera në numrat e raportuara nga subjektet qeveritare dhe të liçencuarit në*

	këtë raport. Kapitulli 10, jep detajet e harmonizimit të flukseve për vitin 2016 dhe liston të gjitha subjektet që nuk raportojnë në 2016, duke përfshirë publikimin e ndikimit bazuar në raportimin e njëanshëm nga njësitë qeveritare. *Rekomandimet për përmirësime janë gjithashtu të listuara në Raportin EITI 2016.* *MSG Shqiptare po harton dhe aprovon një plan veprimi për ndjekjen e Rekomandimeve të EITI 2016, kështu që të gjitha kërkesat do të mbulohen për të përmirësuar raportimin EITI në Shqipëri.*
KËRKESA EITI 5 **Shpërndarja e të ardhurave** 5.1 Shpërndarja e të ardhurave të industrisë nxjerrëse 5.2 Transfertat në nivel kombëtar 5.3 Manaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve	***Shpërndarja e të ardhurave nga industria nxjerrëse*** *Renta mblidhet nga shitjet e tatueshme të naftës, gazit dhe mineraleve dhe regjistrohen në Buxhetin e Shtetit. Sipas Ligjit për taksat kombëtare nr. 9975, datë 28 korrik 2008, ndryshuar, një pjesë e tatimit mbi të drejtën e rentës do të ndahet për secilën njësi të qeverisjes vendore ("NJQV") në proporcion me kontributin e tyre në prodhimin e brendshëm të naftës, gazit dhe minerareve. Kuadri rregullator për transfertat lokale të rentës deri në nëntor të vitit 2014, Ligji për taksat kombëtare kërkoi që 25% e rentës të ndahet për secilën njësi të qeverisjes vendore ("NJQV") në proporcion me kontributin e tyre, brenda afatit të të ligjit të buxhetit vjetor. Formula për ndarjen e rentës në NJQV-të përfituese nuk është publikuar dhe transferimet e bëra nuk mund të lidhen me kontributin e NJQV-ve në mbledhjen e rentës. Deri në vitin 2014, vetëm vendet që prodhojnë naftë mund të përfitojnë nga transferimet lokale të rentës.* *Më 27 nëntor 2014, Qeveria Shqiptare paraqiti ndryshime në Ligjin për Taksat Kombëtare, ku NJQV-të kanë të drejtë të marrin 5% të rentës së gjeneruar nga shitjet e naftës dhe mineraleve të nxjerra në zonën e tyre. Sipas këtyre kushteve të reja, transfertat e rentës lidhen me kontributin e NJQV-ve dhe nuk ndikohet nga ndonjë transferim tjetër buxhetor në përputhje me ligjin vjetor të buxhetit. Udhëzimi nr. 26, datë 4.9.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar ("udhëzimi"), liston proçedurat e barazimit që duhet të kryhen nga NJQV-të përfituese për të siguruar alokimin e drejtë të rentës. Prandaj, çdo NJQV do të bjerë dakord që në fund të muajit pagesat e rentës të bëra nga të liçencuarit që veprojnë në zonën e NJQV-së, me drejtorinë rajonale të taksave dhe*

	doganave. Drejtoritë rajonale të taksave dhe doganave duhet të dorëzojnë listën analitike të NJQV-ve të mbledhura dhe të përfituara nga reduktimi i të ardhurave në Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Financave ("MF"). Pas marrjes së rakordimit, MF fillon transferimet mujore të rentës të autorizuara në NJQV. Në rastin e kompanive të naftës, të cilat veprojnë në të njëjtën kohë në disa NJQV, udhëzimi përcakton pjesën e rentës që do të ndahet. *Aktualisht, qeveria shqiptare po shqyrton përsëri përqindjen e rentës që do të transferohet në NJQV.* ***Transfertat në nivel kombëtar**. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është në proçes përmirësimi të proçedurave në mënyrë që të sigurohet për saktësinë dhe plotësinë e shpërndarjes së rentës në përputhje me kërkesat e reja ligjore. Sipas ndryshimeve të bëra, gjatë vitit 2015 NJQV-të kanë të drejtë të marrin 5% të rentës minerare të gjeneruara nga Shoqëritë që prodhojnë në zonën e tyre pa marrë parasysh ndonjë transferim të parashikuar në përputhje me ligjin e buxhetit vjetor. Udhëzim Nr.26, datë 4.9.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar përcakton procedurat rakorduese për alokimin e rentës minerar. Sipas këtij udhëzimi, NJQV-të në duhet të kryejnë rakordimet me drejtoritë rajonale të tatimeve dhe doganave në fund të cdo muaji dhe të nisin këto rakordime pranë* *Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave. Njëkohësisht drejtoritë rajonale të tatimeve dhe doganave duhet të dergojnë brenda muajit informacion analitik për rentën e mbledhur dhe NJQV-të përfituese. Mbi bazën e rakordimeve Ministria e financave kryen transfertat e rentës NJQV-ve përfituese në muajin pasardhës.* *Për shoqëritë e naftës, veprimtaria e të cilave shtrihet në disa NJQV njëkohësisht, udhëzimi përcakton përqindjen e rentës që do t'i shkojë çdo NJQV-je në varësi të vendburimit ku është prodhuar nafta apo gazi i shitur.* ***Manaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve*** *Të ardhurat e mbledhura nga Buxheti Shtetit nga industria nxjerrëse bashkohen me të ardhurat e tjera në buxhet dhe alokohen natyrshëm nëpër zërat e buxhetit. Nuk ka alokim specifik të këtyre të ardhurave në programe të buxhetit me përjashtim të Rentës Minerare ku 5% i kalon pushtetit*

	vendor sipas zonave ku ushtron aktivetitet industria nxjerrëse. Njëkohësisht këto të ardhura përbëjnë rreth 5% të Buxhetit. *AKBN menaxhon vetë një pjesë të të ardhurave nga Marrëveshjet Hidrokarbure. Deri tani AKBN nuk ka dhënë informacion se si alokohen këto të ardhura në buxhetin e saj.* *Shteti shqiptar mbledh të ardhura nga sektori i naftës dhe gazit nëpërmjet ndarjes së prodhimit të naftës, bonuset, rentën minerare, tatimit mbi fitimin dhe divident, të ardhura nga punësimi. Në raport tregohet shpërndarja e të ardhurave totale të gjeneruara nga operacionet e naftës midis Qeverisë Shqiptare, shoqërisë Albpetrol, AKBN-së dhe shoqërive private të naftës. Interesi i Shtetit Shqiptar në PSA administrohet nga Albpetrol dhe AKBN, të cilat marrin nga PSA-të: bonuse, pjesë nga prodhimi i naftës dhe të ardhurave të tjera që rrjedhin nga mos-zbatimi i termave të kontratave si gjoba dhe garanci të ekzekutuara. MIE publikon informacion financiar lidhur me shpenzimet sipas natyrës dhe programit në faqen e saj të internetit http://infrastruktura.gov.al/*
KËRKESA EITI 6 **Shpenzimet sociale dhe ekonomike** 6.1 Shpenzimet sociale nga kompanitë nxjerrëse 6.2 Shpenzimet fiskale 6.3 Kontributi i sektorit nxjerrës në ekonomi	***Shpenzimet sociale*** *janë shpenzime materiale të bëra nga kompanitë ne sektorin e Industrive Nxjerrëse në dobi të publikut dhe shoqërisë civile, siç është mandatuar me ligj ose me kontratën me qeverinë.* *Qeveria dhe kompanitë e naftës të përfshira në sektorin e naftës informuan se aktualisht Marrëveshjet në fuqi të naftës nuk përfshijnë pagesa sociale të detyrueshme që duhet të kryhen nga kompanitë e naftës në dobi të komuniteteve.* *Koha dhe shuma e pagesave sociale vendosen* *nga kompanitë e naftës në diskrecionin e tyre.* *Shoqëritë duhet t'i paraqesin këto shpenzime për AKBN/ Albpetrol për miratim si pjesë e miratimit vjetor të buxhetit.* ***Shpenzimet fiskale.*** *MSG Shqipëri diskutoi në takimin e datës 12.02.2019 ekzistencën e shpenzimeve kuazi-fiskale në Shqipëri dhe materialitetin e tyre. Deklarata e MSG për këtë çështje do të dërgohet veçmas në Sekretariatin Ndërkombëtar dhe do të mbulohet në Raportin e ardhshëm EITI.* ***Kontributi i sektorit nxjerrës në ekonomi****. Bazuar në të dhënat e raportuara nga*

	agjencitë qeveritare të paraqitura në Raportin e EITI 2016, sektori nxjerrës dhe hidroenergjia llogariten në mënyrë kolektive jo më shumë se 6% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2016, në shumën 87,483 milionë lekë. Eksportet nga sektori nxjerrës janë rritur ndjeshëm me mbi 100% deri në vitin 2013, kur arritën në 96.7 miliardë lekë ose 39% të totalit të eksporteve. Kjo përqindje ka rënë në 19% të totalit të eksporteve në vitin 2016 ose 47.0 miliardë lekë, ndikuar njëkohësisht nga rënia e çmimeve ndërkombëtare për naftën dhe rritja e aktivitetit të rafinimit të naftës në vend. Bazuar në të dhënat e raportuara nga DPT, mbajtësit e liçencave të përfshirë në sektorin nxjerrës në sektorit e naftës, minerareve dhe hidroçentraleve kanë të punësuar përafërsisht 16,500 staf ku përbëjnë 1.4% të fuqisë punëtore të regjistruar nga INSTAT në dhjetor 2016.
KËRKESA EITI 7 **Rezultatet dhe ndikimi** 7.1 Debati publik 7.2 Aksesueshmëria e të dhënave 7.3 Mospërputhjet dhe rekomandimet nga Raportet EITI 7.4 Shqyrtimi i rezultateve dhe ndikimin e zbatimit të EITI	***Debat publik**.Raporti EITI në Shqipëri është i kuptueshëm dhe i aksesueshëm publikisht. Të dyja Raportet EITI dhe Skeda e Përmbledhjes së të Dhënave janë në dispozicion në format të hapur të të dhënave. Gjithashtu, kopjet e raporteve EITI prodhohen vazhdimisht dhe u shpërndahen palëve të interesuara.* *Raportet publikohen në faqen e internetit www.albeiti.org në gjuhën shqipe dhe angleze.* *Raporti i EITI Shqipëri është përdorur gjerësisht nga palët e interesuara në debate publike.* *Organizimi i takimeve me gazetarët nga mediat vendore dhe kombëtare, edicionet, shkrimet kronike dhe organizimi i takimeve me grupet e interesit vendore dhe të huaja, tregojnë qartë angazhimin e MSG dhe Sekretariatit Kombëtar EITI për të nxitur një debat publik mbarëkombëtar dhe për të ndikuar në zhvillimin ekonomik dhe social të komuniteteve.* ***Aksesueshmëria e të dhënave.** Sekretariati Kombëtar EITI publikon raportet e EITI në faqen e saj të internetit dhe të gjitha palët e interesuara kanë qasje të plotë për të dhënat e kërkuara. Kopjet fizike të Raporteve EITI dhe Raporteve Përmbledhëse shpërndahen gjerësisht tek palët relevante të interesit.*

	***Mospërputhjet dhe rekomandimet nga Raportet EITI**. Mospërputhjet dhe rekomandimet në Raportet EITI diskutohen në mbledhjet e MSG. Kohët e fundit Sekretariati Kombëtar propozoi që brenda MSG të krijohej një nëngrup i përhershëm. Ky grup do të ndjekë zbatimin e rekomandimeve të Raportit EITI dhe gjithashtu veprimet korrigjuese të ngritura nga Validimi deri në përmbushjen e tyre të plotë.* ***Shqyrtimi i rezultateve dhe ndikimin e zbatimit të EITI.**Për të kapërcyer pengesat që dalin në këtë drejtim, Sekretariati Kombëtar EITI dhe MSG kanë punuar ngushtë me palët e përfshira në proçes. Shumë nga aktivitetet e komunikimit dhe promovimit me të gjithë aktorët u kryen nga Sekretariati Kombëtar EITI dhe MSG.* *Miratimi i Ligjit për Transparencën është premtuese, por në të njëjtën kohë kërkon koordinim të punës nga palët e përfshira.* *2020 do të jetë viti i publikimit të Pronarëve Përfitues dhe si anëtar i EITI, Shqipëria po ndjek hapat e duhur për të përmbushur këtë detyrim global. Një udhërrëfyes i Pronarëve Përfitues për të gjitha hapat që duhen ndjekur është botuar në janar 2017. Sekretariati Kombëtar i EITI ka kryer dhe po kryen të gjitha aktivitetet e parashikuara në këtë udhërrëfyes. Projektligji "Për transparencën e aktiviteteve të industrive nxjerrëse dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore në Republikën e Shqipërisë" përfshin dispozita ligjore për shpalljen e Pronarëve Përfitues.* *Shumë takime janë kryer nga Sekretariati Kombëtar i EITI dhe kohët e fundit nga OShC-të, anëtarët e MSG-së, me Njësitë e Qeverisjes Vendore në fushat ku operojnë industritë nxjerrëse, kompanitë dhe përfaqësuesit e shoqërive civile, për të promovuar EITI-dhe Raportimin EITI.* *Nga ana tjetër, janë organizuar takimeve me gazetarë nga media kombëtare dhe lokale. Informimi i medias mbi punën dhe misionin e iniciativave EITI është një rrugë që pasqyron një angazhim serioz për transparencën në sektorin nxjerrës.* *Risia që solli organizimi i Anketimi EITI ishte për Sekretariatin Kombëtar EITI mënyra më e mirë për të analizuar perceptimin e publikut për ndikimin dhe zbatimin e EITI në Shqipëri.* *Rezultatet e sondazhit treguan se administrata lokale dhe qendrore (e prekur*

	nga raportimi EITI) nuk kishin informacion mbi kërkesat e EITI. *Si rezultat, Sekretariati Kombëtar i EITI vendosi që aktivitetet e parashikuara në Planin e Punës do të luanin një rol kyç në organizimin e aktiviteteve informuese kryesisht duke u fokusuar në këtë grup.* *Mund të shprehim se qeveria vendore (kur operon industria nxjerrëse) dhe administrata qendrore duke iu përgjigjur me kohë dhe me cilësi kërkesave dhe detyrimeve të Nismës EITI dëshmon që Plani i Punës EITI ka arritur objektivin në këtë drejtim.* ***Rritja progresive e kompanive raportuese në EITI.*** *Gjatë viteve, përqindja e raportimit nga kompanitë nxjerrëse u rrit në mënyrë progresive, duke synuar një përfshirje më të madhe të sektorëve.* *I. Në sektorin e naftës për Raportet EITI kanë raportuar 100% të kompanive që operojnë në këtë sektor.* *II. Në sektorin e minierave, numri i kompanive është rritur nga viti në vit dhe përqindja e prodhimit të realizuar nga këto kompani në terma konkretë është:* *1. Në vitin 2012, 69 kompani, duke raportuar 77.1% të prodhimit minerar.* *2. Në 2013, 81 kompani, duke raportuar 85% të prodhimit të minierave.* *3. Në vitin 2014, 99 kompani, që raportojnë 87% të prodhimit minerar.* *4. Në 2015, 105 kompani, që raportojnë 89% të prodhimit minerar.* *5. Në 2016, 128 kompani raportuan, 90% të prodhimit të minierave.* *III. Në sektorin e energjisë elektrike kanë raportuar kompanitë kryesore që veprojnë në këtë sektor.* *1. Në vitin 2015, 13 kompanitë, që raportojnë 90% të prodhimit të energjisë elektrike.* *2. Në 2016, 12 kompani, që raportojnë 90% të prodhimit të energjisë elektrike.* *Ndryshimet e shpeshta brenda stafit në disa prej institucioneve kanë shkaktuar konfuzion dhe vështirësi, por qasja miqësore midis palëve ka sjellë në rezultate konkrete.*

PËRMBLEDHJE E PËRGJIGJEVE TË MSG PËR REKOMANDIMET NGA RAKORDIMI DHE VALIDIMI, NËSE ËSHTË E APLIKUESHME *NË PËRPUTHJE ME KËRKESËN 7.4. (a)(iii)*

MSG-ja gjatë gjithë vitit 2018 dhe në vijim ka diskutuar vazhdimisht dhe ka marrë masa për veprimet korrigjuese të dala nga proçesi i Validimit të Parë dhe nga vendimi i Bordit EITI në lidhje me Validimin e Shqipërisë, i datës 13. 02. 2019. Një përmbledhje të shkurtër të masave të marra i gjeni të renditura si më poshtë:

Veprimi korrigjues 1 *(#1.3)*

Shoqëria civile në përputhje me veprimin korrigjues nr. 1.3 ka draftuar dhe dorëzuar brenda afatit të përcaktuar nga Bordi Ndërkombëtar EITI, 13 Maj 2019, Planin e veprimit dhe pse pak para fillimit të Validimit të dytë por brenda afatit, ka organizuar zgjedhjet e reja duke përcaktuar anëtarët e saj të rinjë në MSG. Koordinimi mes anëtarëve të shoqërisë civile, përfaqësues në MSG është përmirësuar dhe është rritur edhe kapaciteti i grupimit të shoqërisë civile në 12 shoqata.

Veprimi Korrigjues 2 *(1.4.a.ii, 1.4.b.ii, 1.4.b.iii 1.4.b.vi)*

Në përputhje me kërkesën 1.4.a.ii dhe 1.4.b.vi, MSG-ja ridiskutoi proçedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të MSG-së dhe me Vendimin nr. 2, datë15.05.2019, dakordësoi ndjekjen me rigorozitet të proçedurave të përzgjedhjes të anëtarëve të parashikuara në Rregulloren e Brendëshme të MSG-së dhe vlerësimin e tyre. Gjithashtu të gjithë grupet e interesit të përfshirë në MSG publikuan proçedurat e përzgjedhjes së anëtarëve në website-et përkatëse: www.albeiti.org ; www. http://fiaalbania.al/; www. albneteiti.org;

Në lidhje me prezencën e Albpetrolit në MSG, gjatë vitit, Albpetrol sh.a. u bë anëtar me të drejta të plota në MSG në grupimin e kompanive të industrisë nxjerrëse.

MSG-ja në bashkëpunim me Sekretariatin EITI Shqipëri dhe Shoqëria Civile gjatë vitit 2018 kanë ndërmarrë aktivitete të ndryshme komunikimi duke informuar palët e interesit për implementimin e EITI-t në Shqipëri.

Veprimi Korrigjes 3 *(requirement #2.2)*

Për sa i përket veprimit korrigjues 3 Shqipëria gjatë vitit 2018 ka bërë një punë dhe një progres të kënaqshëm në lidhje me publikimin e dhënies dhe transferimit të liçensave. Përveç publikimit të tyre në QKB, një punë e madhe është bërë nga ana e MSG-s dhe Sekretariatit EITI Shqipëri për plotësimin e informacionit dhe publikimin e tij në website-in, www.albeiti.org

Pra në formë të përmbledhur, MSG-ja në bashkëpunim me Sekretariatin ka punuar gjatë gjithë vitit 2018 dhe po vijon punën për plotësimin total të Corrective Actions të dala nga Misioni i II i Validimit.

Duke u bazuar në Raportin Final të Validimit të II-të dhe mbasi janë kontrolluar hapat e ndërmarra për të adresuar 12 Corrective Actions, nga Misioni i Validimit II i është sugjeruar Bordit EITI që të marrë në konsideratë edhe veprimet e ndërmarra mbas fillimit të Misionit të II të Validimit (13 shkur 2019). Në një rast të tillë Shqipëria ka adresuar plotësisht 7 nga 12 Corrective Actions, duke pasur "progress të kënaqshëm" dhe në kërkesat e tjera ka "progress domethënës" me përmirësime të konsiderueshme.

NDONJË PIKË E FORTË OSE DOBËSITË E IDENTIFIKUARA NË PROÇESIN EITI

NË PËRPUTHJE ME KËRKESËN 7.4. (a)(v)

PIKË E FORTË

Është rritur dukshëm në mënyrës sasiore dhe cilësore bashkëpunimi i Grupeve të Interesit në MSG, dhe sidomos veprimtaria e Shoqërisë Civile si në aktivitete komunikimi dhe sensibilizimi të kryera nga vetë grupimi i Shoqërisë Civile, ashtu edhe në bashkëpunimin aktiv të implementimit të proçeseve EITI në Shqipëri.

DOBËSITË

Vonesa për shkaqe objektive e fondeve të miratuara nga ana e BB ka vonuar realizimin e aktiviteteve konform afateve të parashikuara në Planin e Punës.

ZBATIMI I PLANEVE PËR PUBLIKIMIN E PRONARËVE PËRFITUES

NË PËRPUTHJE ME KËRKESËN 7.4. (a)(vi)

Publikimi i Pronarëve Përfitues në 2020 si një nga Kërkesat themelore të EITI Ndërkombëtar por edhe një nga rekomandimet e Komisionit Europian për Shqipërinë ka nxitur palët e interesuara veçanërisht Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të nisin punën për hartimin e një ligji të ri. Ky ligj synon të krijojë një regjistër i cili do të zbardhë emrat e Pronarëve Përfitues të kompanive të regjistruara në parajsat fiskale me aktivitet në Shqipëri. Asistenca Ndërkombëtare që po merret për hartimin dhe zbatimin e këtij ligji synon aksesueshmërinë mbi të dhënat e subjekteve, nga data e krijimit, vendimet e ndryshme dhe deri tek bilancet financiare duke bërë kështu Transparencë mbi origjinën e llogarive bankare.

Grupi Ndërinstitucional i Punës (MSG) duke pasur në tryezën e punës, Drejtues nga institucionet e përfshira në hartimin e këtij ligji është duke e ndjekur me përparësi këtë proçes dhe beson se ky ligj do të ketë forcën e tij zbatuese, në Janar 2020.

KOSTOJA TOTALE E IMPLEMENTIMIN

Sekretariati Kombëtar EITI për vitin 2018 u financua nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe nga fondet e Projektit Grant TF0A1769 i Bankës Botërore.

Financimi nga Buxheti i Shtetit ishte në shumën 12,500,000 Lekë dhe mbuloi shpenzimet e pagave dhe sigurimeve të personelit si dhe u përdor për shpenzime operative.

Projekti Grand TF0A1769 i Bankës Botërore u përdor në shumën 46,721.72 USD për pagesat e konsulentëve të kontraktuar nën këtë Grant.

Stafi faktik i Sekretariatit Shqiptar EITI për vitin 2018 është 8 punonjës, nga të cilët 7 punonjës me kohë të plotë dhe 1 punonjës me kontratë nga kontigjenti i studentëve të rinj të sapombaruar, kundrejt 9 punonjësve që ka Organigrama.

NDONJË KOMENT SHTESË

Proçedurat që u ndoqën nga Qeveria Shqiptare dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim mbi letërmarrëveshjen ndryshuese Nr.2 të marrëveshjes së grandit Nr. TF0A1769, sollën vonesa dhe fondi i planifikuar nga ky Grant për të financuar aktivitetet e Planit të Punës EITI për vitin 2018, nuk u arrit të përfitohet dhe zbatohet nga Sekretariati Kombëtar EITI.

ËSHTË DISKUTUAR VEPRIMTARIA E RAPORTIT PËRTEJ MSG-SË

NË PËRPUTHJE ME KËRKESËN 7.4.b

Takimet me përfaqësues nga Ambasada Zviceriane dhe Prezenca e OSBE në Shqipëri, organizimi i takimeve në nivel lokal, Konferenca Raporti EITI 2016 si dhe pjesëmarrja në Panairet për sektorin nxjerrës, janë treguesi që veprimtaria EITI është prezantuar dhe diskutuar me të gjitha palët që kanë treguar gjithashtu interes të kountribuojnë në këtë proçes.

DETAJE MBI ANTARËSINË E MSG

Ndryshimet organizative në disa Institucione Shtetërore por dhe lënia vakante e dy vendeve nga Grupimi i Shoqërisë Civile, solli nevojën e një nxitjeje nga ana e Kryetarit të MSG për plotësimin e menjëhershëm dhe ristrukturimin e MSG. Institucionet Shtetërore i janë përgjigjur menjëherë shkresës zyrtare duke dërguar antarin e ri përfaqësues në MSG nga Institucioni përkatës. Grupimi i Shoqërisë Civile në MSG për shkak të mungesës së fondeve nuk arriti të organizoj zgjedhjet e këtij grupimi gjatë vitit 2018 por arriti ti plotësoj vëndet vakante në 12 Shkurt 2019 dhe antarët e rinj u prezantuan gjatë takimit të MSG organizuar po në të njëjtën datë. Një nga rekomandimet e dala nga Proçesi i Validimit 2018 për Shqipërinë ishte dhe prezenca e kompanisë me Kapital Shtetëror, Albpetrol, si anëtar me të drejtë vote, kërkesë e cila u pranua dhe u miratua unanimisht nga MSG. Axhenda e takimeve, Minutat e Takimit, Listë Prezenca dhe Vendimet e MSG për periudhën 2018 gjenden në faqen zyrtare të internetit të EITI Shqipëri http://www.albeiti.org/viti-2018/.

FOTO NGA AKTIVITETET

E APROVUAR NGA MSG DATË 28 QERSHOR 2019